

Kostandini e Dhoqma

BOTIMET
TOENA
TIRANE

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

Al vajti i ra nê gu... i tha:
- Eshtë i mirë se është i do... është trim edhe bujar,
është pasun... kalojë jetë të
lumtur. Pasat... chendri. Ma ka
thënë vetë me gojet e sa... këtë krujshqi. Më
të mirë dhënderr s'kemi...
Mëma u mendua gjatë... Kostandinit:

Kostandini e Dhoqina

Ilustrimet nga:
VEHAP KOKALARI



BOTIMET TOENA
TIRANË 1999





Na jetonte dikur një mëmë që na kishte nëntë djem dhe një vajzë. I shoqi kishte rënë në luftërat për liri dhe mëma i kishte rritur të dhjetë fëmijët me djersën e gjakun e saj. Prandaj edhe i donte më shumë se mëmat e tjera. Vajzën e quanin Dhoqinë aenmbanë vendit tonë, po arbërit e Kalabrisë në Itali e quanin Garentinë. Djalin e vogël e quanin Kostandin.

U rrit e u selit Dhoqina dhe u bë për t'u martuar. E kërkuan sa e sa trima e bujarë, po asnjeri s'e mori dot se mëma e donte afër, ndërsa dhëndurrët vinin që nga larg.

Një ditë na erdhi një bujar që nga vise shumë të largëta dhe e kërkoi për nuse Dhoqinën. Mëma me të tetë djemtë nuk donte që nuk donte t'ia jepnin, ndërsa Kostandini, i cili u bë shok e mik me të, këmbënbuli që ta bënin krushqinë.

Ai vajti i ra në gjunjë mëmës dhe i tha:

- Është i mirë se është i dashur, është trim edhe bujar, është pasunar i madh dhe me të Dhoqina do kalojë jetë të lumtur. Pastaj edhe Dhoqinës i pëlqen dhëndrrri. Ma ka thënë vetë me gojën e saj. Bëje, o mëmë, këtë krushqi. Më të mirë dhëndërr s'kemi ku gjejmë.

Mëma u mendua gjatë dhe pastaj iu kthyte Kostandinit:



- Të gjitha të mirat i ka dhëndrrri, po është shumë larg prej këndejej. Unë e dua Dhoqinën afër... Se larg qoftë, o biri im, po pata ndonjë hidhërim ku do ta gjej time bijë? Pastaj, po të kem ndonjë gëzim, Dhoqina do të mungojë e zemra do të më pëlcasë.





- Eh, moj mëma ime e dashur. Po mua pse më ke këtu? Do të shkoj vetë ta marr, edhe sikur të jetë prapa diellit, dhe do të ta sjell në çast. Kostandini të jep edhe fjalën edhe besën. Mirë?

Nga lutjet e përgjërimet e Kostandinit mëma pranoi dhe e martuan Dhoqinën pas nëntë malesh, nëntë fushash e nëntë lumenjsh, me dhëndrrin bujar e pasunar.

Viti i parë kaloi dhe Dhoqina ishte e lumtur si rrallëkush.

Po vitin e dytë na erdhi një armik i zi si nata dhe në betejë ra edhe Kostandini me vëllezërit e vet. I varrosi nëna, fshati e atdheu me nderime të mëdha, në varrezat pranë kishës. Pastaj e ëma i ngjeu me bojë të zezë jashtë e brenda dhomat, shkallët, korridoret, dyert e dritaret. Me të zeza ishte veshur edhe vetë, që nga majë e flokëve gjë te gishtërinjtë e këmbëve.






Kaloi një ditë e kaluan dy, kaloi një javë e kaluan dy, kaloi një muaj e kaluan dy dhe dalëngadalë kaloi edhe viti që të nëntë djemtë preheshin afër njëri-tjetrit në varreza. Një të djelë mëmëzeza u ngrit dhe shkoi në kishë e pastaj të varret e të bijve. Mbi çdo varr ndezi nga një kandile dhe qau me ngashërim, mbi varrin e Kostandinit ndezi dy kandile. Pastaj nisi e qau me ligje:

- Kostandin, o biri im, ku e ke fjalën e besën që më dhe? Kaloi një vit e nuk u kujtove asnjëherë të ma sjellësh që ta shoh e të qajmë të dyja bashkë për ju e për fatin tonë të zi. A thua do ta mbash fjalën e besën tani që po të kujtoj të më sjellësh Dhoqinën?

Dhe pastaj u kthyte në shtëpi.







Sa nisi të erret varri i Kostandinit u
hap si me magji dhe pllaka u bë kalë,
dheu iu bë shalë e kryqi fre i argjentë.

shtëpia e së mëtrës





I hipi kalit Kostandini dhe sa të
hapësh e të mbyllësh sytë arriti te
shtëpia e së motrës.

Në oborr gjeti djalin e saj, që po
bridhte pas dallëndysheve dhe e pyeti:
- Ku e ke nënën, o im nip?
Ai ende s'dinte të fliste, ndaj me dorë
i tregoi sheshin e fshatit, ku
vlonte kënga e vallja.



Vrapoi
Kostandini
dhe i thirri
së motrës:

- Motra
ime, o
Dhoqinë e
dashur, eja
të nisemi
sa më parë
se po të
pret nëna.

Ka më shumë se një vit që s'të ka parë....

- Po të shkojmë për gëzim, vij me rrobat që kam veshur. Po të shkojmë për hidhërim, të vishem si kallogrinjë..., - iu lut e motra.

- iu lut e motra.

- Eja kështu siç je veshur, sepse koha nuk na pret, - i tha i vëllai.

Dhe i hipën kalit të dy bashkë.



Duke ecur e duke biseduar, motra e pyeti tē vëllanë:

- Pse krahët e tu tē gjerë më duken si tē mykur?
- M'i ka tymosur tymi i luftrave, o motër, - iu përgjigj Kostandini.
- Po flokët e tu tē bukur e tē dredhur, pse tē qenkan mbushur gjithë pluhur?
- Të bëjnë sytë, o motër, se sytë t'i ka pahitur pluhuri i rrugës.

Kur u afruan te vendlindja, Dhoqina e pyeti përsëri tē vëllanë:

- Pse s'kanë dalë vëllezërit tē na presin?
- Ata do tē jenë duke hedhur valle në shesh tē fshatit dhe nuk e dinë që do tē vije, se unë nuk i lajmërova...
- Po muret e dritaret e shtëpisë pse janë ngjer me bojë tē zezë? Pastaj dyert e dritaret pse janë tē mbyllura?

Se na fryn era e detit, në këtë dimër tē keq...



Kur shkuan pranë kishës, Kostandini i tha së motrës:

- Unë po futem në kishë, se kam një lutje për të bërë. Ti ecë rrugës drejt dhe sakaq shkon në shtëpi. Pas teje do të vij dhe unë.

Dhoqina mori rrugën për në shtëpi ndërsa Kostandini shkoi në varreza dhe në çast kali u kthye në pllakë, shala iu kthye në dhë dhe freri i argjentë iu kthye në kryq...

Dhoqina sosi me një frymë te dera e shtëpisë, trokiti tri herë dhe thirri e ngashëryer:

- Hape, o mëmë derën, se jam Dhoqina e vetme...

Nëna, që ishte plakur jo nga pleqëria po nga gjëma që e kishte gjetur, nuk dëgjonte mirë nga veshët dhe e pyeti:

- Kush je ti që po troket? Ik tutje, o bushtra vdekje, që më more nëntë djemtë dhe tanë ke marrë zërin e sime bije e vjen të më marrësh edhe mua!


- Nuk jam bushtra vdekje, o mëmë, po hape se jam Dhoqina, - thirri fort e bija sa e dëgjoi gjithë fshati.





Mëma e njohu nga zëri dhe në çast e hapi derën. Pastaj e pyeti të bijën:

- O Dhoqinë, o shpirti e syri im, kush të solli gjer këtu?
- Më ka sjellë Kostandini, im vëlla...
- Po ku është biri im?



- Ai shkoi gjer në kishë se kishte një lutje për të bërë. Do të vijë shumë shpejt.

- Ç'thuas kështu, o Dhoqinë? Kostandini im ka vdekur, bashkë me vëllezërit e tjerë.

Kanë dhënë jetën për lirinë e atdheut.

Sa dëgjoi këto fjalë, Dhoqina u mbështet tek e ëma, ndërsa mëmëzeza u mbështet tek e bija.

Dhe ashtu siç ishin të përqafuara,

*një në prag e një në derë,
plasën si qelqe me verë!*

LEGJENDA SHQIPTARE - 10

libra të ilustruar për fëmijë

KOSTANDINI E DHOQINA

Autor: *Odhise Grillo*

Piktor: *Vehap Kokalari*

Përkujdesja grafike: *Irena Toçi*

Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

KOSTANDINI DHE DHOQINA

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

KALAJA E ROZAFATIT

NËNA ME ZEMËR TË MADHE